



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

KPPP.nr. 234/22

GJYKATA KOMERCIALE, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, Gjyqtari Hasan Kryeziu, në çështjen përmbartimore të kreditorit Qeveria e Republikës së Kosovës - Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale – Inspektorati i Punës, me seli në Prishtinë, rr. “Qamil Hoxha”, kundër debitorit “Princesha C...”, sh.p.k, me NRB ....., me seli në Prishtinë, të përfaqësuar nga Afrim Salihu avokat nga Prishtina, duke vendosur lidhur me prapësimin e debitorit të ushtruar kundër Urdhrit Përmbartimor P.nr.704/19 të datës 14.03.2019 të Përmbartuesit Privat Flamur S. Bogaj, me seli në Prishtinë, jashtë seancës me datën 02.09.2022, merr këtë:

A K T V E N D I M

I. REFUZOHET në tërësi si i pabazuar prapësimi i debitorit “P...”, sh.p.k, me seli në Prishtinë, i paraqitur kundër Urdhrit Përmbartimor P.nr. 704/19, të datës 14.03.2019, i lejuar nga Përmbartuesi Privat Flamur S. Bogaj.

II. MBETET NË FUQI Urdhri Përmbartimor P.nr.704/19, i datës 14.03.2019, i lejuar nga Përmbartuesi Privat Flamur S. Bogaj.

A r s y e t i m

Kreditori, Qeveria e Republikës së Kosovës - Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale – Inspektorati i Punës ka parashtruar propozim për përmbartim kundër debitorit “Princesha Construction”, sh.p.k, me seli në Prishtinë, për përmbushjen e detyrimit sipas dokumentit përmbartues – Vendimi 01.Nr.40-133/2018/A të datës 03.11.2018, i formës së prerë prej datës 24.12.2018 dhe i ekzekutueshëm prej datës 24.12.2018, me të cilën debitori është obliguar që kreditorit në emër të masës ndëshkimore t’ia paguaj shumën prej 10,000.00€ (dhjetë mijë euro) në afat prej 8 ditësh, nga dita e pranimit të vendimit në xhirollogarinë Nr. .... B... sipas numrit të Vendimit.

Përmbaruesi Privat Flamur S. Bogaj, me seli në Prishtinë, duke vepruar sipas propozimit të kreditorit Qeveria e Republikës së Kosovës - Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale – Inspektorati i Punës, me datë 14.03.2019, ka lëshuar Urdhrin Përmbarimor P.nr.704/19, me të cilin ka lejuar përmbarimin në bazë të dokumentit përmbarues, Vendimit të Inspektoratit të Punës 01.Nr.40-133/2018/A, të datës 03.11.2018 me të cilën është detyruar debitori që në afat prej 7 (shtatë) ditësh, t’ia paguaj kreditorit në emër të masës ndëshkimore shumë prej 10,000.00 € (dhjetë mijë euro), nën kërcënim të ekzekutimit të dhunshëm me ndalimin e mjeteve të cilat debitori i ka në llogaritë bankare dhe mjeteve të luajtshme në pronësi të tij, si dhe shpenzimet e procedurës përmbarimore sipas Udhëzimit Administrativ MD.NR.06/2014.

Debitori “P...”, sh.p.k, përmes të autorizuarit të saj, avokatit Afrim Salihu , brenda afatit ligjor ka paraqitur prapësim me shkrim, duke theksuar se debitori ka paraqitur ankesë ndaj vendimit të inspektoratit të punës tek divizioni për shqyrtimin e parashtresave dhe ankesave në Ministrinë e Punës dhe Mirëqenies Sociale, si dhe ka iniciuar konflikt administrativ për anulimin e aktvendimit lidhur me shqiptimin e gjobës duke shtuar më tutje se inicimi i procedurës përmbarimore dhe marrja e urdhrin përmbarimor është ligjërisht i paqëndrueshëm sepse deri sa lënda është duke u gjykuar në konflikt administrativ nuk ka asnjë qëndrueshmëri ose bazë ligjore që mund ta lejoj ekzekutimin e aktvendimit në procedurën përmbarimore. Më tutje ka shtuar se nuk ka logjikë që të ekzekutohet vendimi dhe në rast se gjykata e refuzon prapësimin e debitorit, atëherë kreditori dhe vendimi i saj janë mbi ligjin dhe gjykatë në vete, sepse vendimi ka marrë formën e prerë dhe se kjo për debitorin është jo ligjore, e paqëndrueshme jo logjike dhe sistem i gjyqimit në veti. Më tutje ka shtuar se për çështjen përmbarimore është paraqitur në padi kronologjia e rastit dhe se në këtë çështje debitori është investitor i projektit ndërsa punë kryes është Diellona Construction Sh.p.k dhe se debitori mbi bazën e kësaj nuk mund të ketë legjitimitet pasiv. Në fund i ka propozuar gjykatës që urdhri i lejuar nga përmbaruesi të hudhet poshtë si jo i ligjshëm, në disproporcion me gjendjen faktike dhe të shfuqizohet dhe të mos lejohet përmbarimi nga përmbaruesi.

Kreditori nuk ka paraqitur përgjigje në prapësim.

Gjykata pas shqyrtimit të pretendimeve të debitorit të paraqitura në prapësim dhe pas shqyrtimit dhe vlerësimit të provave që gjenden në shkresat e lëndës, duke iu referuar dispozitave të nenit 69 dhe 71 të Ligji Nr. 04/L-139 për Procedurën Përmbarimore, (tutje LPP) gjeti se

prapësimi i debitorit është në tërësi i pabazuar andaj të njëjtin e refuzoi dhe vendosi si në dispozitiv të këtij Aktvendimi, për shkaqet si në vijim:

Gjykata vlerëson se organi përmbarues ka lejuar përmbarimin bazuar në nenin 21 të LPP-së i cili përcakton se: *“Organi përmbarues e cakton, përkatësisht e zbaton përmbarimin vetëm në bazë të dokumentit përmbarues (titulus executionis) dhe dokumentit të besueshëm, po qe se me këtë ligj nuk është parashikuar diçka tjetër.”*

Gjykata ka shqyrtuar dokumentin përmbarimor, përkatësisht Vendimin 01.Nr.40-133/2018/A, në bazë të së cilit përmbaruesi privat ka lejuar përmbarimin dhe gjeti si i njëjti, sipas nenit 22 paragrafit 1, nën paragrafi 1.2 të LPP-së, është përcaktuar si dokument përmbarues sipas të cilit mund të caktohet përmbarimi për realizimin e kërkesës në të holla. Po ashtu Vendimi 01.Nr.40-133/2018/A, i përmban të gjitha elementet e përcaktuara në nenin 27 paragrafin 1, sipas të cilit: *“Dokumenti përmbarimor është i përshtatshëm për përmbarim në qoftë se në të është treguar kreditori dhe debitori, si dhe objekti, mjetet, shuma dhe koha e përmbushjes së detyrimit”,* pasi që në të është treguar kreditori, debitori, objekti, mjetet, shuma dhe koha e përmbushjes së detyrimit.

Gjykata vlerëson se në rastin konkret Vendimin 01.Nr.40-133/2018/A, i plotëson kushtet e përcaktuara në nenin 36 paragrafin 1 të LPP-së, sipas të cilit përcaktohet se: *“Së bashku me propozimin për përmbarim, organit përmbarues i dorëzohet edhe dokumenti përmbarues, origjinal apo kopje e vërtetuar, me klauzolën e përmbarueshmëris për përmbarueshmëri”,* dhe paragrafin 2 të po të njëjtit nen, sipas të cilit përcaktohet se: *“Vërtetimin për përmbarueshmërin e jep Gjykata, respektivisht organi shtetëror që ka vendosur për kërkesën në procedurën e shkallës së parë”,* ngase Vendimi 01.Nr.40-133/2018/A i datës 03.11.2018, i nxjerrë nga Inspektorati i Punës, është bërë i formës së prerë me datë 24.12.2018 dhe i ekzekutueshëm me datë 24.12.2018.

Gjykata vlerësoi pretendimet e debitorit të paraqitura në prapësim se në rastin konkret nuk ka asnjë qëndrueshmëri ose bazë ligjore që mund ta lejoj ekzekutimin e aktvendimit në procedurën përmbarimore deri sa lënda është duke u gjykuar në konflikt administrativ dhe gjeti se një pretendim i tillë nga ana e debitorit është në tërësi i pa bazuar nga fakti se Vendimi 01.Nr.40-133/2018/A, i datës 03.11.2018 përbën dokument përmbarimor konform nenit 24 par.3 të LPP-së, me të cilën përcaktohet se *“Vendimi i dhënë në procedurë administrative është përmbarimor, po*

*qe se i tillë është bërë sipas rregullave me të cilat është rregulluar procedura e tillë.”, e po ashtu bazuar në dispozitën e nenit 22 të Ligjit Nr. 03/L-202 për Konfliktet Administrative, me të cilën është përcaktuar se: “Padia nuk e ndalon ekzekutimin e aktit administrativ kundër të cilit është paraqitur përveç kur kjo me ligj është parashikuar ndryshe”, rezulton se paraqitja e padisë nuk paraqet pengesë për ekzekutimin e aktit administrativ në procedurën përmbarimore dhe si rrjedhojë nuk e ndalon përmbarimin.*

Gjykata po ashtu i vlerësoi edhe pretendimet e debitorit se në këtë procedurë i mungon legjitimiteti pasiv meqenëse i njëjti është investitor i projektit (në hapësirat ku është inspektuar ndërtimi) ndërsa “D... C...”, sh.p.k është punë kryese dhe gjeti se pretendimet e tilla nuk janë objekt shqyrtimi i procedurës përmbarimore dhe nuk mund të vlerësohen në këtë procedurë, ngase kjo procedurë i nënshtrohet parimit të rigorozitetit formal, në bazë të së cilit nuk lejohet vlerësimi i rrethanave tjera, përpos vlerësimit të elementeve formale të dokumentit në bazë të cilit është lejuar përmbarimi, si dhe përshtatshmërisë së vendimit objekt përmbarimi.

Nga arsyet e paraqitura më lartë, dhe duke u bazuar në nenet 21, 22 par.1 pika 1.2, 24, 27, 36 par.1 dhe 2, 73 par.3 të LPP-së, dhe nenit 13 par.1 nën par 1.2 të Ligjit nr. 08/L-015 për Gjykatën Komerciale, vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA KOMERCIALE, Dhomat e Shkallës së Parë

Departamenti për Çështje Ekonomike

KPPP.nr.234/22, datë 02.09.2022

Gjyqtari

Hasan Kryeziu

**KËSHILLA JURIDIKE:** Kundër këtij aktvendimi

palët kanë të drejtë ankese në afat prej shtatë (7) ditëve,

nga dita e pranimit të aktvendimit, në Dhomat e Shkallës së Dytë,

në Gjykatën Komerciale, në Prishtinë, përmes Dhomave të Shkallës së parë të kësaj Gjykate.